

Data 03.07.2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - “Procedurë e hapur - Punë publike - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara (me rihapje konkurrimi pas lidhjes së marrëveshjes kuadër)

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Spostim i linjave të tensionit të lartë në aksin Korridor VIII”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për tubacione, linja komunikimi dhe energjie, për autostrada, rrugë 45230000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 166,651,167.26 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë njëzet e gjashtë) **Lekë, pa TVSH**

Në bazë të *Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024 Autoriteti/Enti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:*

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për vitet 2026-2028, sipas shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 2741/3 prot, datë 15.04.2026.

Argumenti juridik dhe teknik mbi llojin e përzgjedhjes së procedurës

Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur - Punë publike - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara (me rihapje konkurrimi pas lidhjes së marrëveshjes kuadër), (projektim dhe zbatim)

Objekti i prokurimit konsiston në projektimin dhe realizimin e punimeve **për spostimin e linjave të tensionit të lartë përgjatë akseve rrugore**, sipas nevojave që do të paraqiten gjatë periudhës së zbatimit të investimeve infrastrukturore.

Ky objekt paraqet karakteristika të veçanta teknike dhe juridike, të cilat e bëjnë objektivisht të pamundur përcaktimin paraprak të të gjitha kushteve të kontratës në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Konkretisht, si më poshtë:

- nuk ekziston projekti;
- ekziston vetëm një preventive paraprak;
- nuk ekziston preventivi përfundimtar i punimeve;
- nuk mund të përcaktohen sasi të reale të punimeve, pasi ato varen nga projektet rrugore që do të zhvillohen gjatë kësaj periudhe, nga kushtet reale në terren, nga konfigurimi i rrjetit elektrik dhe nga zgjidhjet teknike që do të miratohen për secilin rast;

Në këto kushte mungojnë elementet thelbësore të një kontrate të zakonshme pune, konkretisht:

- projekti;
- sasi të reale;
- zërat përfundimtarë të punimeve;
- konfigurimi teknik;
- vlera reale e çdo ndërhyrjeje.

Për rrjedhojë, lidhja e një kontrate klasike pune do të binte në kundërshtim me parimin e mirëadministrimit të fondeve publike, pasi operatorët ekonomikë do të ofertonin mbi elemente të pasakta ose hipotetike, duke krijuar rrezik për oferta të pakrahasueshme, pretendime gjatë zbatimit dhe nevojë për ndryshime të vazhdueshme kontraktore.

Për këtë arsye, autoriteti kontraktor ka vlerësuar se mjeti juridik më i përshtatshëm është **marrëveshja kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara**, e zhvilluar nëpërmjet procedurës së hapur ndërmjet kufijve monetarë.

Përzgjedhja e kësaj procedure mbështetet në *Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar)*, i cili rregullon marrëveshjet kuadër si mjet për prokurimin e kontratave kur nevojat do të materializohen gjatë një periudhe të caktuar dhe kur nuk është e mundur të përcaktohen paraprakisht të gjitha elementet e kontratës.

Në zbatim të *VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar*, në dispozitat mbi marrëveshjet kuadër (Nenet 59-64), parashikohet shprehimisht mundësia e lidhjes së një marrëveshjeje kuadër me disa operatorë ekonomikë, **ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara**, duke përcaktuar se kontratat individuale lidhen vetëm pas rihapjes së konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në marrëveshje.

Në rastin konkret, pikërisht ky mekanizëm garanton respektimin e parimeve të konkurrencës, pasi çdo kontratë individuale do të konkurrohet mbi elementët që nuk mund të përcaktohen në fazën fillestare, si:

- vendndodhja konkrete e ndërhyrjes;
- projekti teknik;
- zgjidhja inxhinierike;
- sasitë reale të punimeve;
- preventivi përfundimtar;
- afatet e realizimit;
- organizimi i punimeve.

Rihapja e konkurrimit nuk përbën një procedurë të re prokurimi, por mekanizmin e parashikuar nga ligji për plotësimin e kushteve që objektivisht nuk mund të përcaktohen në momentin e lidhjes së marrëveshjes kuadër.

Nga pikëpamja teknike, spostimi i linjave të tensionit të lartë nuk është një punim standard. Çdo ndërhyrje përbën një projekt të veçantë inxhinierik, pasi kushtëzohet nga:

- tensioni nominal i linjës;
- konfigurimi ekzistues i rrjetit;
- tipologjia e shtyllave;
- kushtet gjeologjike dhe topografike;
- kërkesat për sigurinë elektrike;
- kufizimet e projektit rrugor;
- miratimet teknike dhe operacionale të operatorit të rrjetit.

Për këtë arsye, nuk ekziston mundësia që, në momentin e tenderimit, të hartohet një projekt unik dhe një preventiv i detajuar për të gjitha ndërhyrjet që mund të lindin gjatë katër viteve të vlefshmërisë së marrëveshjes.

Po ashtu, vetë natyra e kësaj marrëveshje kuadër që përfshin (hartimin e projektit të zbatimit + zbatimin) nënkupton që projekti është pjesë e detyrimeve kontraktore të operatorit ekonomik. Për rrjedhojë, preventivi përfundimtar mund të hartohet vetëm pas projektimit të secilës ndërhyrje, çka e bën juridikisht dhe teknikisht të pamundur përcaktimin paraprak të sasive reale dhe të çmimeve përfundimtare në fazën e tenderimit.

Përdorimi i marrëveshjes kuadër shmang gjithashtu nevojën për zhvillimin e një procedure të re prokurimi për çdo rast të veçantë të spostimit, duke garantuar reagim në kohë ndaj nevojave operative, vazhdimësi në realizimin e investimeve publike, ulje të kostove administrative dhe

ruajtje të konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes.

Për këto arsye, zgjedhja e marrëveshjes kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, përbën jo vetëm një mundësi të parashikuar nga legjislacioni i prokurimit publik, por edhe zgjidhjen e vetme që i përgjigjet natyrës së këtij objekti, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, transparencës, proporcionalitetit, konkurrencës dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike.

➤ **Në DST është përcaktuar:**

Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

- Për të provuar përvojën e mëparshme (**punë të ngjashme**):
 - Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”
- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (**licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës**):
 - Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

Argumentimi

Në mbështetje të *Nenit 84, pikat 6 dhe 7, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Nenit 90, pikat 5 dhe 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar*, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se për aspektet kritike të kontratës nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Autoriteti Kontraktor ka vendosur që operatorët ekonomikë nuk mund të mbështeten në licencën e shoqërisë apo në përvojën për punë të ngjashme të subjekteve të tjera për plotësimin e kriterëve të kualifikimit.

Ky përcaktim lidhet me natyrën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në punime komplekse për postimin e linjave të tensionit të lartë, punime që kërkojnë kapacitete profesionale, organizative dhe teknike të konsoliduara, të disponueshme drejtpërdrejt nga operatori ekonomik që merr përsipër ekzekutimin e kontratës.

Licenca profesionale për ushtrimin e veprimtarisë në këtë fushë përfaqëson autorizimin ligjor për kryerjen e punimeve dhe lidhet ngushtë me subjektin që e zotëron atë. Në të njëjtën mënyrë, përvoja në realizimin e punëve të ngjashme përbën provë të aftësisë reale organizative dhe teknike të operatorit ekonomik për të përballuar ekzekutimin e kontratës.

Duke qenë se punimet lidhen me infrastrukturë kritike të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike, ku çdo ndërhyrje duhet të garantojë standarde të larta sigurie, cilësie dhe vazhdimësie të furnizimit, Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto kapacitete duhet të zotërohen nga vetë operatori ekonomik ofertues dhe nuk mund të plotësohen përmes mbështetjes në subjektet e tjera.

Ky kufizim është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe synon të sigurojë që kontrata të realizohet nga operatorë që disponojnë vetë kapacitetin profesional dhe përvojën e nevojshme për realizimin e punimeve objekt prokurimi, duke ulur rrezikun e mosrealizimit ose të realizimit jo në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në DST paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Sigurimit të Ofertës, Formularit të Ofertës dhe Listës së Çmimeve sipas shtojcave përkatëse të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Megjithëse Formulari i Ofertës dhe Lista e Çmimeve janë pjesë përbërëse e DST-ve, përfshirja e tyre në këtë pikë është bërë për qëllime qartësie, transparence dhe administrimi korrekt të procedurës, me synim evidentimin e dokumenteve kryesore që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë në momentin e dorëzimit të ofertës.

Kjo mënyrë formulimi nuk shton kërkesa të reja kualifikimi dhe nuk krijon barrierë për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, por shërben vetëm për të rikujtuar detyrimin për paraqitjen

e dokumenteve të domosdoshme që garantojnë vlefshmërinë, krahasueshmërinë dhe vlerësimin korrekt të ofertave.

Përvoja e Autoritetit Kontraktor në administrimin e procedurave të prokurimit ka evidentuar raste të mosparaqitjes ose paraqitjes së paplotë të këtyre dokumenteve nga operatorët ekonomikë, çka ka sjellë vështirësi në procesin e vlerësimit të ofertave.

Për këtë arsye, evidentimi i tyre në mënyrë të veçantë synon vetëm garantimin e paraqitjes së plotë të dokumentacionit të ofertës dhe zhvillimin normal të procedurës së prokurimit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas Shtojcës 8

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e kapacitetit profesional sipas Shtojcës 8 është përcaktuar në mbështetje të Nenit 77, pika 1, shkronja "a" dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe Nenit 41, pika 4 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Përmes Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori ekonomik deklaron përmbushjen e kërkesave që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë profesionale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë i shërben verifikimit paraprak të aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë për të ushtruar ligjërisht aktivitetin objekt prokurimi dhe është në përputhje me natyrën e kontratës dhe kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024), si dhe në Nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar).

Ky kriter është vendosur me qëllim verifikimin objektiv të kapacitetit ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë, duke garantuar se ata disponojnë një nivel minimal të qëndrueshmërisë financiare të nevojshme për realizimin e kontratave që burojnë nga marrëveshja kuadër.

Duke qenë se procedura ka natyrë të marrëveshjes kuadër me rihapje konkurrimi dhe parashikon realizimin e punimeve në disa faza gjatë një periudhe shumëvjeçare, operatori ekonomik duhet të ketë aftësi financiare për të përballuar flukse të konsiderueshme monetare që lidhen me mobilizimin e burimeve njerëzore, pajisjeve, materialeve dhe kostove operative gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Kërkesa që xhiroja vjetore e një prej viteve të jetë të paktën sa vlera e fondit limit të marrëveshjes kuadër përbën një tregues të thjeshtë, të matshëm dhe objektiv të kapacitetit ekonomik të operatorit, duke reflektuar aftësinë e tij për të menaxhuar kontrata me volum dhe kompleksitet të ngjashëm me objektin e prokurimit.

Ky nivel është vendosur në mënyrë proporcionale dhe nuk përbën kufizim të panevojshëm të konkurrencës, pasi nuk kërkohet shumëfish i fondit limit, por vetëm një nivel minimal i krahasueshëm me ekspozimin maksimal të mundshëm financiar që rrjedh nga zbatimi i marrëveshjes kuadër.

Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor siguron pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë me kapacitete të mjaftueshme financiare për realizimin e suksesshëm të kontratave, në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të *Ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 është vendosur në mbështetje të *Nenit 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar*, si dhe *Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar*.

Ky kriter synon të verifikojë gjendjen ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë, si dhe aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga realizimi i kontratës. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin punë publike, realizimi i kontratës kërkon një gjendje financiare të qëndrueshme, e cila garanton aftësinë e operatorit ekonomik për të siguruar materialet e

nevojshme, makineritë dhe pajisjet e ndërtimit, fuqinë punëtore, si dhe për të përballuar shpenzimet operative gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Kërkesa që bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme të mos paraqesin raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit është vendosur për të provuar një aktivitet ekonomik të qëndrueshëm dhe një gjendje financiare të shëndoshë të operatorit ekonomik, duke minimizuar rrezikun e vështirësive financiare gjatë ekzekutimit të kontratës dhe duke garantuar vazhdimësinë normale të punimeve deri në përfundimin e tyre.

Përcaktimi i viteve financiare 2023, 2024 dhe 2025 është bërë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe kontabël në fuqi, referuar *Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"*, *Ligjit nr. 29/2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat"*, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilat përcaktojnë detyrimin për hartimin dhe depozitimin e pasqyrave financiare vjetore.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit**, është jo më e vogël se **dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
 - Aktin e kolaudimit

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
 - Akt kolaudimi objekti;

Shënim: *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

2.3.1/2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

2.3.1/3 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Ky kriter është vendosur me qëllim verifikimin objektiv të aftësisë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë për realizimin e kontratave me natyrë dhe kompleksitet të ngjashëm me objektin e prokurimit, i cili konsiston në punime të specializuara në infrastrukturën e transmetimit të energjisë elektrike, përfshirë ndërhyrje në linja të tensionit të lartë dhe elementë të lidhur me to.

Duke qenë se punimet objekt i kësaj procedure karakterizohen nga kompleksitet teknik i lartë, kërkesa të veçanta për siguri në punë, koordinim me operatorët e sistemit energjetik dhe realizim në kushte operative të kufizuara, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë të kenë provuar më parë aftësinë e tyre për të menaxhuar kontrata me përmasa të konsiderueshme dhe natyrë të ngjashme.

Përcaktimi i dy alternativave për plotësimin e kriterit synon të rrisë konkurrencën dhe të mos kufizojë pjesëmarrjen vetëm në operatorë me një kontratë të vetme të madhe, por edhe në ata që kanë përvojë të konsoliduar të shpërndarë në disa kontrata të ngjashme, duke reflektuar në mënyrë më të plotë kapacitetin e tyre profesional.

Kërkesa që për bashkimet e operatorëve ekonomikë përvoja të plotësohet në raport me pjesëmarrjen e tyre në bashkim synon të sigurojë proporcionalitet midis angazhimit në kontratë dhe eksperiencës reale të secilit anëtar, duke shmangur situatat ku një anëtar me kapacitet të kufizuar mbështetet në përvojën e pjesës tjetër të grupit për të përmbushur detyrime të rëndësishme teknike.

Dokumentacioni i kërkuar për vërtetimin e përvojës (kontrata, situacione, faturë tatimore dhe akt kolaudimi) synon të garantojë verifikueshmëri të plotë të punimeve të deklaruara, duke siguruar që vetëm kontratat e realizuara me sukses dhe të pranuar nga autoritetet përkatëse të merren në konsideratë gjatë vlerësimit.

Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor siguron një nivel të mjaftueshëm garancie se operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë:

2.3.2/1 Kategoritë e mëposhtme :

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1-A	Punime gjurmimi në tokë

2	NP-2-A	Ndertime civile dhe industriale
3	NP-11-D	Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
4	NP-12-A	Punime inxhinierike mjedisore
5	NS-1-A	Punime per prishjen e ndertimeve

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024); Nenin 39, pika 6/a, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe me VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Kërkesa për paraqitjen e licencës profesionale të shoqërisë është vendosur në përputhje me legjislacionin në fuqi për veprimtarinë e ndërtimit dhe është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në punime për spostimin e linjave të tensionit të lartë përgjatë aksit të Korridorit VIII.

Punimet objekt i marrëveshjes kuadër përfshijnë ndërhyrje në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, punime gërmimi, punime ndërtimore për bazamentet dhe strukturat mbështetëse, punime për ndërtimin dhe rikonstruksionin e elementëve të linjave të tensionit të lartë, si dhe punime ndihmëse mjedisore dhe të prishjes së objekteve ekzistuese, sipas nevojave që do të përcaktohen në kontratat pasuese.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë kategoritë e licencës profesionale **NP-1-A, NP-2-A, NP-11-D, NP-12-A dhe NS-1-A**, të cilat mbulojnë të gjitha llojet e punimeve që mund të realizohen gjatë zbatimit të marrëveshjes kuadër. Kategoritë e kërkuara janë vendosur vetëm në masën e nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe nuk tejkalojnë kërkesat teknike të tij.

Në veçanti, kategoria **NP-11-D** është kërkesë thelbësore, pasi lidhet drejtpërdrejt me ndërtimin dhe ndërhyrjet në linjat e tensionit të lartë, nënstacionet dhe rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, që përbëjnë objektin kryesor të kontratës. Kategoritë e tjera të licencës janë kërkuar për shkak se gjatë realizimit të punimeve do të kryhen edhe punime gërmimi, punime civile, punime mjedisore dhe, sipas rastit, prishje të objekteve ose strukturave ekzistuese.

Kërkesa që operatorët ekonomikë të huaj të paraqesin licenca të ekuivalentuara pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është vendosur për të garantuar trajtim të barabartë ndërmjet

operatorëve vendas dhe të huaj, si dhe për të verifikuar që kapacitetet profesionale të tyre përmbushin kërkesat e legjislacionit shqiptar për ushtrimin e veprimtarisë së ndërtimit.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është në përputhje me parimet e proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe konkurrencës, pasi licencat e kërkuara janë të domosdoshme për realizimin e sigurt dhe cilësor të punimeve objekt prokurimi dhe nuk vendosin kufizime më të gjera se sa kërkon natyra e kontratës.

Duke qenë se kemi të bëjmë me Marrëveshje Kuadër për 4 vite dhe për shkak se kontratat pasuese mund të përfshijnë kombinime të ndryshme të punimeve të parashikuara në preventivin orientues, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë që në fazën e kualifikimit të gjitha kategoritë e licencave që mbulojnë gamën e plotë të punimeve që mund të porositen gjatë afatit të marrëveshjes kuadër.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1-A	Punime gjurmimi në tokë	Punime gjurmimi në trupin e rrugës	0-20 milion	16,306,985.30
NP-2-A	Ndërtime civile dhe industriale	Përfshin gjithë punimet civile dhe industriale	0-20 milion	16,306,985.30
NP-11-D	Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Përfshin punimet për ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë		163,069,853.08

NP-12-A	Punime inxhinierike mjedisore	Punime të mjedisit	0-20 milion	16,306,985.30
NS-1-A	Punime per prishjen e ndertimeve	Punime për prishjen e ndërtimeve	0-20 milion	16,306,985.30

Shënim:

Kategoria D e pikës NP-11 e licencës është përcaktuar nga vlera e gjithë punimeve të zbatimit, ndërsa vlera e kategorive të tjera është llogaritur si 10% e vlerës së punimeve të zbatimit

2.3.2/2 Personelin kryesor **drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi**
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik**
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi**
- 1 (nje) Inxhinier Topograf / Gjeodet**
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik**

**** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.8, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.*

****Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtimesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar me VKM Nr. 545, datë 04.09.2024), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të disponojë në licencën profesionale personelin kryesor drejtues teknik, të përbërë nga **1 (një) Inxhinier Ndërtimi, 1 (një) Inxhinier**

Elektrik, 1 (një) Inxhinier Mjedisi, 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet dhe 1 (një) Inxhinier Mekanik, pasi këto profile profesionale janë të domosdoshme për realizimin e punimeve objekt të marrëveshjes kuadër.

Objekti i prokurimit konsiston në spostimin e linjave të tensionit të lartë përgjatë aksit të Korridorit VIII, proces i cili përfshin punime të natyrës elektrike, civile, gjeodezike, mekanike dhe mjedisore, që kërkojnë koordinim multidisiplinor gjatë projektimit të zbatimit, organizimit, mbikëqyrjes dhe realizimit të punimeve. Konkretisht;

- **Inxhinieri Elektrik** është i domosdoshëm për organizimin dhe mbikëqyrjen e punimeve në linjat e tensionit të lartë, montimin dhe çmontimin e elementëve elektrikë, si dhe garantimin e respektimit të standardeve teknike dhe të sigurisë në rrjetin e transmetimit.
- **Inxhinieri Ndërtimi** është i nevojshëm për drejtimin e punimeve civile, ndërtimin e bazamenteve, rikonstrukcionin e elementëve mbështetës dhe kontrollin e cilësisë së punimeve ndërtimore.
- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet** është i domosdoshëm për rilevimet topografike, piketimin, verifikimin e koordinatave dhe kontrollin e pozicionimit të strukturave të reja përgjatë gjurmës së linjës.
- **Inxhinieri Mjedisi** është i nevojshëm për monitorimin e zbatimit të masave të mbrojtjes së mjedisit, rehabilitimin e zonave të prekura dhe respektimin e kërkesave të legjisllacionit mjedisor gjatë realizimit të punimeve.
- **Inxhinieri Mekanik** është i nevojshëm për organizimin dhe mbikëqyrjen e montimit dhe çmontimit të elementëve metalikë të linjave, përdorimin e pajisjeve mekanike dhe kontrollin teknik të proceseve që lidhen me ngritjen dhe instalimin e strukturave mbështetëse.

Kërkesa që këta specialistë të jenë drejtues teknikë të shoqërisë dhe të figurojnë në licencën profesionale garanton që operatori ekonomik disponon kapacitetet profesionale të nevojshme për realizimin e punimeve gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

Po kështu, kërkesa për paraqitjen e kontratës së punës, diplomës, librezës së punës, CV-së dhe dokumentacionit që provon sigurimin sipas legjisllacionit në fuqi ka për qëllim verifikimin e marrëdhënies reale të punës, kualifikimit profesional dhe disponueshmërisë së personelit të deklaruar, duke garantuar që stafi i propozuar do të jetë efektivisht në dispozicion për realizimin e kontratave pasuese.

Duke qenë se kjo procedurë zhvillohet në formën e një marrëveshjeje kuadër me afat katërvjeçar dhe me rihapje të konkurrimit, Autoriteti Kontraktor vlerëson se disponimi i këtij personeli përbën një kërkesë minimale dhe proporcionale, e domosdoshme për të garantuar realizimin e sigurt, cilësor dhe në përputhje me standardet teknike të të gjitha punimeve që mund të kontraktohen gjatë zbatimit të marrëveshjes.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi ose të kontraktojë me një shoqëri projektuese të licencuar sipas rregullores së miratuar me VKM Nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

Nr.	Kategoria	Fusha e projektimit	Pika
1	3	PROJEKTUES KONSTRUKTOR	a- Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate b-2. objekte me skelet metalik
2	4	PROJEKTUES INSTALATOR	c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
3	10	PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE	d- Nënstacione elektrike, primare sekondare - linja të tensionit të lartë

Shënim:

Në lidhje me vlefshmërinë e licencave ekzistuese dhe përshtatjen e kategorive me përshkrimet përkatëse, ofertuesit të mbajnë parasysh VKM Nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016. **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.**

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të disponojë licencë projektimi ose të kontraktojë një shoqëri projektuese të licencuar, pasi natyra e objektit të prokurimit kërkon, përveç realizimit të punimeve, edhe hartimin dhe përshtatjen e dokumentacionit teknik të nevojshëm për zbatimin e çdo kontrate pasuese.

Marrëveshja kuadër ka si objekt spostimin e linjave të tensionit të lartë përgjatë aksit të Korridorit VIII dhe është ndërtuar mbi një preventiv paraprak orientues, ndërsa ndërhyrjet konkrete,

vendndodhjet, zgjidhjet teknike dhe sasitë përfundimtare do të përcaktohen gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes kuadër, në varësi të nevojave të Autoritetit Kontraktor dhe kushteve të secilës kontratë pasuese. Për këtë arsye, për çdo ndërhyrje mund të lindë nevoja për hartimin ose përditësimin e projektit të zbatimit, bazuar në kushtet reale në terren dhe kërkesat teknike të rrjetit të transmetimit.

Për këtë qëllim është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë ose të sigurojë, nëpërmjet një kontrate me një subjekt të licencuar, kapacitete projektuese në fushat:

- **Kategoria 3 – Projektues Konstruktor**, për projektimin e bazamenteve, strukturave mbështetëse dhe elementëve konstruktivë që lidhen me zhvendosjen ose ndërtimin e strukturave të reja;
- **Kategoria 4 – Projektues Instalator**, për projektimin e linjave dhe rrjeteve elektrike që lidhen me objektin e kontratës;
- **Kategoria 10 – Projektimi i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike**, në veçanti për projektimin e linjave të tensionit të lartë dhe elementëve përkatës të rrjetit të transmetimit.

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar mundësinë që operatori ekonomik ta përmbushë këtë kriter edhe nëpërmjet kontraktimit të një shoqërie projektuese të licencuar, duke mos kufizuar pjesëmarrjen në procedurë vetëm tek operatorët që disponojnë vetë licencën e projektimit. Kjo zgjidhje garanton respektimin e parimit të konkurrencës dhe të proporcionalitetit, ndërkohë që siguron disponueshmërinë e kapaciteteve profesionale të nevojshme për realizimin e objektit të kontratës.

Kërkesa që subjektet e huaja të paraqesin licenca të ekuivalentuara sipas legjislacionit shqiptar është vendosur për të garantuar që të gjithë operatorët ekonomikë, vendas dhe të huaj, të provojnë kapacitete profesionale të barasvlershme dhe të njohura nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit, është i domosdoshëm për realizimin e sigurt dhe teknikisht korrekt të punimeve dhe respekton parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe nxitjes së konkurrencës.

Kërkesa për disponimin e kapaciteteve projektuese lidhet me faktin se dokumentacioni teknik ekzistues është paraprak dhe orientues; për rrjedhojë, gjatë zbatimit të marrëveshjes kuadër do të kërkohet hartimi ose përshtatja e projekteve të zbatimit për secilën ndërhyrje konkrete, në përputhje me kushtet reale në terren, standardet teknike të OST sh.a. dhe legjislacionin në fuqi.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **15 (pesëmbëdhjetë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për muajin Maj 2026, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin **Maj 2026**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin **Maj 2026**.

Argumentim:

Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Objekti i prokurimit konsiston në spostimin e linjave të tensionit të lartë, punime të cilat përfshijnë procese të ndryshme pune, si gërmime, punime civile, montim dhe çmontim të strukturave metalike, punime elektrike, transport materiale, rikthimin e gjendjes së terrenit dhe aktivitete të tjera ndihmëse. Kryerja e këtyre proceseve kërkon angazhimin e një numri të mjaftueshëm punonjësish për të garantuar organizimin e punës, respektimin e afateve kontraktore dhe zbatimin e kërkesave teknike dhe të sigurisë.

Duke qenë se procedura zhvillohet në formën e një marrëveshjeje kuadër me afat katërvjeçar dhe me rihapje të konkurrencës, kontratat pasuese mund të kenë natyrë dhe volum të ndryshëm punimesh. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar një numër të lartë punonjësish të lidhur me vlerën maksimale të marrëveshjes kuadër, por vetëm një kapacitet minimal bazë, i cili garanton se operatori ekonomik disponon strukturën organizative të nevojshme për fillimin dhe realizimin e punimeve që do t'i ngarkohen.

Numri minimal prej 15 punonjësish është vlerësuar në përputhje me natyrën e punimeve dhe përfaqëson një kërkesë proporcionale, e cila nuk kufizon konkurrencën dhe njëkohësisht siguron që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë kapacitetet minimale njerëzore për realizimin e kontratave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit të lëshuar nga organet kompetente, konkretisht vërtetimit mbi numrin e punonjësve dhe listëpagesave për muajin maj 2026, është vendosur për të verifikuar ekzistencën reale të fuqisë punëtore të deklaruar dhe për të garantuar që operatori ekonomik disponon personel të punësuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përzgjedhja e një muaji të vetëm reference për verifikimin e fuqisë punëtore është bërë në respektim të parimit të proporcionalitetit, pasi shmang vendosjen e barrës administrative të panevojshme mbi operatorët ekonomikë, duke i mundësuar Autoritetit Kontraktor të verifikojë në mënyrë efektive kapacitetin minimal të tyre.

2.3.5 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (**jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë**), si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Ndertimi

1 (nje) Inxhinier Elektrik

1 (nje) Inxhinier Mjedisi

1 (nje) Inxhinier Topograf / Gjeodet

1 (nje) Inxhinier Mekanik

**** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.8, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.*

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të disponojë, përveç drejtuesve teknikë të regjistruar në licencën profesionale të shoqërisë, edhe staf mbështetës të përbërë **nga 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, 1 (një) Inxhinier Elektrik, 1 (një) Inxhinier Mjedisi, 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet dhe 1 (një)**

Inxhinier Mekanik, pasi natyra dhe kompleksiteti i punimeve objekt prokurimi kërkojnë një strukturë teknike që garanton organizimin, koordinimin dhe ndjekjen e punimeve në terren.

Punimet për spostimin e linjave të tensionit të lartë përfshijnë një sërë aktivitetesh që zhvillohen njëkohësisht dhe kërkojnë mbikëqyrje të vazhdueshme në disiplina të ndryshme inxhinierike. Për këtë arsye, drejtuesit teknikë të licencës nuk janë të mjaftueshëm për të garantuar në çdo rast ndjekjen operative të punimeve, veçanërisht duke pasur parasysh se marrëveshja kuadër mund të gjenerojë kontrata pasuese me ndërhyrje në zona të ndryshme ose me procese pune që zhvillohen paralelisht.

Profili i kërkuar i stafit mbështetës lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve:

Inxhinieri Elektrik ndjek zbatimin teknik të punimeve në linjat e tensionit të lartë dhe kontrollon përputhshmërinë me projektin dhe standardet teknike.

Inxhinieri Ndërtimi koordinon dhe monitoron realizimin e punimeve civile dhe të bazamenteve të strukturave.

Inxhinieri Topograf/Gjeodet kryen piktetimet, matjet dhe verifikimet topografike gjatë zbatimit të punimeve.

Inxhinieri Mjedisi monitoron zbatimin e masave të mbrojtjes së mjedisit dhe rehabilitimin e zonave të prekura.

Inxhinieri Mekanik ndjek proceset që lidhen me montimin dhe çmontimin e strukturave metalike, përdorimin e pajisjeve mekanike dhe kontrollin teknik të elementëve konstruktivë.

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar që ky staf nuk është e nevojshme të jetë drejtues teknik i regjistruar në licencën e shoqërisë, çka përbën një zgjidhje më fleksibël dhe më pak kufizuese për operatorët ekonomikë, duke garantuar njëkohësisht disponueshmërinë e specialistëve të nevojshëm për realizimin e kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës së punës, diplomës, librezës së punës dhe CV-së ka për qëllim verifikimin e kualifikimit profesional, përvojës dhe disponueshmërisë reale të personelit të propozuar, duke siguruar që operatori ekonomik ka kapacitetet njerëzore të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi kërkon vetëm specialistët minimalisht të nevojshëm për disiplinat kryesore që përfshin objekti i prokurimit, pa vendosur kërkesa të panevojshme ose kufizuese për operatorët ekonomikë.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 2 (dy) specialistë të certifikuar për bashkim kabllorësh të tensionit të lartë

- **8 (tetë) punonjes te trajnuar dhe te pajisur me certifikate te punimeve ne lartesi** e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.8, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.*

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të disponojë **2 (dy) specialistë të certifikuar për bashkimin e kablove të tensionit të lartë dhe 8 (tetë) punonjës të trajnuar dhe të pajisur me certifikatë për punime në lartësi**, pasi këto kualifikime janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e punimeve objekt të marrëveshjes kuadër dhe janë të domosdoshme për realizimin e tyre në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet e sigurisë. Objekti i prokurimit konsiston në spostimin e linjave të tensionit të lartë, proces që përfshin ndërhyrje në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, montimin dhe çmontimin e elementëve të linjës, si dhe, sipas rastit, realizimin e lidhjeve të kablove të tensionit të lartë. Këto janë procese me karakter të specializuar, të cilat kërkojnë njohuri teknike specifike dhe nuk mund të realizohen nga personel i pakualifikuar.

Kërkesa për **2 (dy) specialistë të certifikuar për bashkimin e kablove të tensionit të lartë** është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik disponon personel të aftë për realizimin e lidhjeve të kablove sipas standardeve teknike të prodhuesve, kërkesave të rrjetit të transmetimit dhe praktikave të sigurta të punës. Cilësia e këtyre punimeve ndikon drejtpërdrejt në funksionimin, sigurinë dhe jetëgjatësinë e rrjetit elektrik, ndaj certifikimi profesional i këtij personeli konsiderohet një kërkesë minimale dhe proporcionale.

Kërkesa për **8 (tetë) punonjës të trajnuar për punime në lartësi** lidhet me faktin se pjesa më e madhe e punimeve do të realizohet mbi shtylla, struktura metalike ose elementë të tjerë të ngritur të linjave të tensionit të lartë. Punimet në lartësi paraqesin rrezik të shtuar për jetën dhe shëndetin e punonjësve, prandaj disponimi i personelit të trajnuar dhe të certifikuar për këtë kategori

punimesh është një masë e domosdoshme për garantimin e sigurisë në punë, uljen e rrezikut të aksidenteve dhe respektimin e legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që certifikatat për punimet në lartësi të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur në Republikën e Shqipërisë, me qëllim garantimin e vlefshmërisë dhe besueshmërisë së trajnimeve të kryera, pa kufizuar pjesëmarrjen vetëm në një institucion të caktuar trajnues.

Numri i specialistëve dhe punonjësve të trajnuar është vlerësuar si minimumi i nevojshëm për të siguruar organizimin dhe realizimin e punimeve në mënyrë të sigurt dhe efikase gjatë zbatimit të kontratave pasuese të marrëveshjes kuadër, pa vendosur kërkesa të panevojshme ose joproportionale për operatorët ekonomikë.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është në përputhje me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës, duke qenë i lidhur drejtpërdrejt me objektin dhe karakteristikat teknike të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 *“Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”*.

**** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.8, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.*

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të disponojë **1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”** dhe **1 (një) punonjës me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”**, pasi objekti i prokurimit përfshin punime me nivel të lartë rreziku, të cilat zhvillohen në linja të tensionit të lartë, në lartësi dhe në kushte operative që kërkojnë zbatimin rigoroz të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Punimet për spostimin e linjave të tensionit të lartë paraqesin rreziqe të shtuara, të lidhura me punën në lartësi, përdorimin e pajisjeve ngritëse, punimet pranë instalimeve elektrike dhe përdorimin e makinerive të rënda. Për këtë arsye, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë personel të trajnuar për organizimin e masave parandaluese, monitorimin e zbatimit të tyre dhe reagimin e menjëhershëm në rast incidentesh ose situatash emergjente.

Kërkesa për **1 (një) punonjës të certifikuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”** synon të garantojë praninë e një personi të aftë për të ofruar ndihmën e parë dhe për të koordinuar ndërhyrjen fillestare në rast aksidenti, deri në mbërritjen e shërbimeve të specializuara. Duke pasur parasysh natyrën e punimeve dhe rrezikun që paraqesin ndërhyrjet në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, disponimi i këtij personeli përbën një masë të domosdoshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve.

Kërkesa për **1 (një) punonjës me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** është vendosur në përputhje me detyrimet e parashikuara në legjislacionin shqiptar për sigurinë dhe shëndetin në punë, konkretisht Ligjin nr. 10327, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Ky specialist është përgjegjës për organizimin dhe monitorimin e zbatimit të masave të sigurisë në kantier, identifikimin e rreziqeve, kontrollin e respektimit të procedurave të punës dhe koordinimin e masave parandaluese gjatë realizimit të punimeve.

Kërkesa që certifikatat të jenë të lëshuara nga subjekte të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur në Republikën e Shqipërisë synon të garantojë vlefshmërinë

dhe besueshmërinë e kualifikimeve profesionale të personelit, pa kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurë.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe përfaqëson një kërkesë minimale e proporcionale, e cila synon garantimin e një mjedisi pune të sigurt, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve, si dhe realizimin e punimeve në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe standardet e sigurisë që aplikohen për ndërhyrjet në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike.

2.3.8 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** (*Inxhinier Ndërtimi / Elektrik*) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe ***nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.***

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: **Diplomë, librezë pune dhe kontratë pune.***

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të përcaktojë, me deklaratë të administratorit të shoqërisë, **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, me profil **Inxhinier Ndërtimi ose Inxhinier Elektrik**, i cili duhet të jetë drejtues teknik i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë periudhës së realizimit të punimeve.

Ky kriter është vendosur duke pasur parasysh natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin punime për spostimin e linjave të tensionit të lartë, me kompleksitet teknik të lartë dhe me rrezik të shtuar për sigurinë e punonjësve dhe të infrastrukturës energjetike. Realizimi i këtyre punimeve kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme teknike, koordinim të ekipeve në terren dhe marrjen e vendimeve të menjëhershme në rast devijimesh nga projekti ose situatash të paparashikuara gjatë zbatimit.

Kërkesa që drejtuesi teknik të jetë **i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë** garanton që ai përbën pjesë të strukturës teknike të operatorit ekonomik dhe disponon kualifikimet profesionale të nevojshme për drejtimin e punimeve objekt kontrate.

Gjithashtu, kërkesa që drejtuesi teknik të mos jetë i angazhuar njëkohësisht në kontrata të tjera apo i deklaruar në procedura të tjera të shpallura fituese, synon të garantojë disponueshmërinë e tij reale dhe efektive gjatë zbatimit të kontratës. Duke qenë se punimet do të realizohen në infrastrukturë kritike të transmetimit të energjisë elektrike, prania e vazhdueshme e drejtuesit teknik është thelbësore për kontrollin e cilësisë së punimeve, respektimin e projektit, zbatimin e masave të sigurisë dhe koordinimin me Autoritetin Kontraktor dhe subjektet e tjera të përfshira në realizimin e punimeve.

Ky kriter nuk kufizon konkurrencën, pasi Autoriteti Kontraktor ka parashikuar që funksioni i drejtuesit teknik mund të ushtrohet nga **Inxhinieri i Ndërtimit ose Inxhinieri Elektrik**, duke i dhënë operatorëve ekonomikë fleksibilitet në organizimin e strukturës së tyre teknike, ndërsa njëkohësisht garanton që drejtimi i punimeve të ushtrohet nga një specialist me profil të përshtatshëm për natyrën e kontratës.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcionale me kompleksitetin e punimeve dhe synon të garantojë realizimin e tyre në përputhje me kërkesat teknike, standardet e cilësisë dhe legjislacionin në fuqi.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Eskavator me kove</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
2	<i>Fadrome</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
3	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
4	<i>Autovinc me kapacitet mbajtes jo me pak se 5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
5	<i>Kamioncina me kapacitet mbajtes mbi 3.5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
6	<i>Motoarganello</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
7	<i>Vinc kulle (pa motoarg)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
8	<i>Makineri terheqje-leshuese percj.,tros, opgw</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Sete 2</i>
9	<i>Prese Hidraulike e motorizuar 120 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Sete 2</i>
10	<i>Kambalec hidraulik per barabanet e kablllove</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Sete 2</i>

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të disponojë makineritë dhe pajisjet e përcaktuara në dokumentet e procedurës, pasi ato përbëjnë kapacitetin minimal teknik të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt të marrëveshjes kuadër.

Objekti i prokurimit konsiston në spostimin e linjave të tensionit të lartë përgjatë aksit të Korridorit VIII, punime që përfshijnë gërmime, ndërtimin e bazamenteve, montimin dhe çmontimin e strukturave mbështetëse, tërheqjen dhe shtrirjen e përçuesve, kablllove dhe OPGW-së, si dhe transportin dhe vendosjen e materialeve dhe pajisjeve. Për realizimin e këtyre proceseve kërkohen mjete dhe pajisje të specializuara, të cilat garantojnë zbatim cilësor, të sigurt dhe në përputhje me kërkesat teknike të objektit.

Kërkesa për secilin mjet është vendosur për shkak të funksionit të tij specifik në realizimin e punimeve:

- **Eskavatori me kovë dhe fadroma** janë të nevojshme për gërmimet, sistemimin e terrenit dhe realizimin e punimeve të tokës.
- **Autobetonieret** janë të nevojshme për transportin dhe hedhjen e betonit në bazamentet e shtyllave dhe elementëve të tjerë konstruktivë.
- **Autovinçi** përdoret për ngritjen, montimin dhe çmontimin e strukturave metalike, izolatorëve dhe elementëve të linjës.
- **Kamioncinat** janë të nevojshme për transportin e materialeve, pajisjeve dhe personelit në kantier.
- **Motoarganellot, vinçat kullë (pa motoarg) dhe makineritë tërheqëse-lëshuese për përçues, tros dhe OPGW** përbëjnë pajisjet bazë për realizimin e operacioneve të tërheqjes, tensionimit dhe montimit të përçuesve dhe kablllove, procese që janë pjesë përbërëse e punimeve të spostimit të linjave të tensionit të lartë.
- **Presat hidraulike të motorizuara 120 ton** janë të nevojshme për realizimin e lidhjeve mekanike të përçuesve dhe elementëve përkatës sipas standardeve teknike.
- **Kambalecët hidraulikë për barabanet e kablllove** përdoren për mbështetjen, rrotullimin dhe shpalosjen e kontrolluar të kablllove gjatë procesit të instalimit, duke garantuar shmangien e dëmtimeve mekanike dhe realizimin korrekt të punimeve.

Autoriteti Kontraktor ka lejuar që këto mjete dhe pajisje të disponohen **në pronësi ose me qira**, duke mos kufizuar pjesëmarrjen vetëm tek operatorët ekonomikë që i zotërojnë në pronësi. Kjo zgjedhje respekton parimin e proporcionalitetit dhe nxit konkurrencën, pasi u krijon mundësi pjesëmarrjeje edhe operatorëve ekonomikë që sigurojnë kapacitetet teknike përmes kontratave të qirasë ose formave të tjera të ligjshme të disponimit.

Numri i mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara është përcaktuar si **minimumi i nevojshëm** për realizimin e punimeve dhe nuk është bazuar në vlerën maksimale të marrëveshjes kuadër, por në nevojën për të garantuar që operatori ekonomik disponon kapacitetet bazë teknike për ekzekutimin e kontratave pasuese që do të lidhen gjatë periudhës katërvjeçare të marrëveshjes.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcional me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve dhe garanton që operatori ekonomik disponon kapacitetin teknik minimal për realizimin e tyre në mënyrë të sigurt, cilësore dhe brenda afateve kontraktore.

Duke qenë se kontratat pasuese do të lidhen gjatë një periudhe katërvjeçare dhe do të kenë objekte konkrete të përcaktuara në momentin e rihapjes së konkurrimit, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar vetëm disponimin e kapaciteteve minimale teknike, pa kërkuar flotë makinerish që korrespondon me vlerën maksimale të marrëveshjes kuadër, duke respektuar kështu parimin e proporcionalitetit.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 *Operatori/et ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

- SSH EN ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*
- SSH EN ISO 14001:2026 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*
- SSH EN ISO 45001:2023 *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024) , sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i

vlerësimin të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë certifikatat si më sipër, pasi këto standarde ndërkombëtare përfaqësojnë garanci objektive për kapacitetin organizativ, teknik dhe menaxherial të operatorëve ekonomikë në realizimin e punimeve objekt të marrëveshjes kuadër. Objekti i prokurimit përfshin punime për spostimin e linjave të tensionit të lartë, të cilat karakterizohen nga kompleksitet teknik i lartë, ndërhyrje në infrastrukturë energjetike kritike dhe ekspozim ndaj rreziqeve të shtuar për sigurinë e punonjësve dhe ndikimet në mjedis. Për këtë arsye, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë të implementuar sisteme të strukturuar të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë.

- **ISO 9001:2015** garanton që operatori ekonomik ka një sistem të menaxhimit të cilësisë që siguron planifikimin, kontrollin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të punës, duke garantuar realizimin e punimeve sipas specifikimeve teknike.
- **ISO 14001:2026** dëshmon që operatori ekonomik ka ngritur dhe zbaton një sistem të menaxhimit mjedisor, i cili është i domosdoshëm për identifikimin, menaxhimin dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore gjatë realizimit të punimeve, veçanërisht në ndërhyrje tokësore dhe infrastrukturore.
- **ISO 45001:2023** garanton që operatori ekonomik ka një sistem të strukturuar për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë, duke marrë parasysh rrezikshmërinë e lartë të punimeve në lartësi dhe në afërsi të linjave të tensionit të lartë.

Kërkesa që certifikatat të jenë të lëshuara nga organe të akredituara ose organizma ndërkombëtarë të njohur në Republikën e Shqipërisë synon të garantojë vlefshmërinë, besueshmërinë dhe njohjen zyrtare të tyre, duke siguruar standarde të njëjta vlerësimi për të gjithë operatorët ekonomikë.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të disponojë certifikatat përkatëse në përputhje me pjesën e punimeve që merr përsipër synon të garantojë që çdo subjekt pjesëmarrës ka të implementuar sistemet minimale të menaxhimit për aktivitetin që do të kryejë, duke siguruar kontroll efektiv të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë gjatë zbatimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcional me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve dhe synon të garantojë realizimin e kontratës sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë.

2.4.2 Grafiku i punimeve.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024), Nenin 39, pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar paraqitjen e **grafikut të punimeve**, me qëllim planifikimin, organizimin dhe monitorimin efektiv të zbatimit të kontratës gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër.

Objekti i prokurimit përfshin punime për spostimin e linjave të tensionit të lartë, të cilat karakterizohen nga kompleksitet teknik i lartë, ndërhyrje në infrastrukturë energjetike kritike dhe domosdoshmëria për koordinim të ngushtë me operatorët e sistemit të transmetimit, si dhe me palë të treta të përfshira në territorin e ndërhyrjes. Për më tepër, duke qenë se procedura zhvillohet si **marrëveshje kuadër me rihapje konkurrimi**, realizimi i punimeve do të ndodhë në faza të ndryshme dhe në kohë të ndryshme, në varësi të kontratave pasuese dhe nevojave operative të Autoritetit Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për grafikun e punimeve është proporcionale dhe e domosdoshme, pasi nuk përbën një barrë shtesë për operatorët ekonomikë, por një instrument teknik i detyrueshëm për organizimin dhe monitorimin e zbatimit të kontratës, në funksion të sigurimit të cilësisë, afateve dhe koordinimit të punimeve.

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe te pika 2.10 e DST-ve. Financimi është parashikuar në buxhetin 2026-2028, por vlera e parashikuar e kontratës kalon 3 (tre) vjeçarin, edhe pse afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.

Argumentimi:

Deklarata e kërkuar shërben për të garantuar që operatori ekonomik është në dijeni dhe pranon skemën e financimit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor; siguruar që nuk do të ngrihen pretendime gjatë zbatimit të kontratës lidhur me mënyrën dhe ritmin e pagesave, të cilat janë të lidhura me buxhetimin vjetor shtetëror; forcuar angazhimin e operatorit ekonomik për respektimin e afateve kontraktore të realizimit të punimeve, pavarësisht strukturës së disbursimit financiar; garantuar vijueshmërinë dhe stabilitetin e zbatimit të kontratës në përputhje me planifikimin buxhetor publik.

Duke qenë se kontrata financohet nga fonde publike dhe zbatimi i saj është i varur nga disponibiliteti buxhetor vjetor, kjo deklaratë përbën një instrument të nevojshëm administrativ që siguron transparencë, parashikueshmëri dhe shmangje të paqartësive gjatë fazës së zbatimit.

Gjithashtu, kërkesa që operatori ekonomik të angazhohet për përfundimin e punimeve brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor është në funksion të garantimit të disiplinës kontraktore dhe realizimit në kohë të investimit publik, duke qenë se punimet objekt kontrate kanë ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo kërkesë është proporcionale, nuk kufizon konkurrencën dhe shërben vetëm për të formalizuar njohjen dhe pranimin e kushteve financiare dhe afateve të zbatimit, të cilat burojnë nga vetë natyra e financimit publik dhe planifikimi buxhetor shumëvjeçar.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar).

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike dhe Termat e Referencës të hartuara për procedurën e prokurimit me objekt **"Spostim i linjave të tensionit të lartë në aksin Korridori VIII"** janë konceptuar në përputhje me natyrën komplekse të ndërhyrjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, si dhe me nevojën për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe vazhdimësisë së shërbimit publik energjetik.

Objekti i prokurimit përfshin punime të karakterit inxhinierik civil, elektrik, mekanik dhe mjedisor, të cilat realizohen në një infrastrukturë kritike kombëtare, ku çdo ndërhyrje kërkon standarde të larta teknike, koordinim të specializuar dhe respektim rigoroz të rregullave të sigurisë në punë. Për këtë arsye, Specifikimet Teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që të sigurojnë një përshkrim të qartë të kërkesave minimale teknike, pa orientuar procedurën drejt një operatori të caktuar ekonomik dhe pa kufizuar konkurrencën.

Termat e Referencës përcaktojnë në mënyrë të detajuar objektivat e ndërhyrjes, fushën e punimeve, kërkesat funksionale dhe teknike, si dhe standardet që duhet të respektohen gjatë realizimit të punimeve. Duke qenë se ndërhyrjet në linjat e tensionit të lartë shpesh realizohen në kushte operative të kufizuara (stakime të planifikuara, ndërhyrje në korridore ekzistuese, koordinim me

operatorët e sistemit), dokumentacioni teknik është ndërtuar mbi bazën e nevojës për fleksibilitet operacional dhe realizim me faza, në përputhje me grafikun e punimeve dhe marrëveshjen kuadër.

Për më tepër, duke qenë se një pjesë e ndërhyrjeve mbështetet në një preventiv orientues dhe jo në një projekt përfundimtar të detajuar për çdo zë pune, Termat e Referencës janë hartuar në mënyrë funksionale, duke përcaktuar kërkesat për rezultatin përfundimtar të punimeve, standardet e cilësisë dhe sigurisë, si dhe kërkesat për pajtueshmëri me normat kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e ndërtimit dhe energjisë.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se Termat e Referencës janë të hartuara në mënyrë proporcionale dhe objektive, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, duke garantuar që kërkesat teknike të jenë të lidhura drejtpërdrejt me nevojën reale të projektit dhe të mos krijojnë barriera të panevojshme për konkurrencën.